

VENDIM
Nr. 22, datë 9.1.2013

PËR DISA SHTESA NË VENDIMIN NR. 370, DATË 15.9.1997 TË KËSHILLIT TË
MINISTRAVE “PËR HAPJEN E MISIONIT TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË PRANË
SELISË SË NATO-S, BRUKSEL”, TË NDRYSHUAR

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 5 e 15 të ligjit nr. 9095, datë 3.7.2003 “Për shërbimin e jashtëm të Republikës së Shqipërisë”, me propozimin e Ministrit të Mbrojtjes, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Në vendimin nr. 370, datë 15.9.1997 të Këshillit të Ministrave, të ndryshuar, të bëhen shtesat e mëposhtme:

a) Në fund të pikës 2/1 shtohet një nënndarje, me këtë përmbajtje:

“- 3 (tre) këshilltarë për politikën e mbrojtjes, civilë, të barasvlershëm me gradën kolonel.”.

b) Pas pikës 2/1 shtohet pika 2/2, me këtë përmbajtje:

“2/2 Këshilltarët për politikën e mbrojtjes janë personel i Ministrisë së Mbrojtjes dhe trajtohen si të tillë edhe pas përfundimit të shërbimit në Përfaqësinë Ushtarake, pranë Përfaqësisë së Përhershme të Republikës së Shqipërisë në NATO, Bruksel. Me përfundimin e shërbimit, këshilltarët kthehen në pozicionin e mëparshëm të punës ose në një pozicion të barasvlershëm me të.”.

2. Efektet financiare që rrjedhin nga zbatimi i këtij vendimi të përballohen nga buxheti i Ministrisë së Mbrojtjes.

3. Ngarkohen Ministria e Mbrojtjes dhe Ministria e Punëve të Jashtme për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë, botohet në Fletoren Zyrtare dhe i shtrin efektet nga data 1 janar 2013.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha